

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 566/1prot

Shkodër, më 08.09.2023

**Lënda: Mbi vendimin Nr.62, datë 28.08.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.**

**KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS**


Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji Nr.107/2016 datë 02.10.2016 “Për Prefektin”, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175, datë 9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksi I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, në mbështetje të nenit 54 shkronja ç, nenit 55/2, neni 64/c të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, dispozitave të ligjit Ligjit Nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, VKM Nr.328/2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, analizoj **VKB Vau Dejës Nr.62, datë 28.08.2023** “Për miratim të nivelit të pagave të policisë bashkiake Vau Dejës për vitin 2023, me burim financimi VKB Vau Dejës Nr.84/2022 Buxheti i vitit 2023”.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**PREFEKTI**

**Majlinda ANGONI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr 62 Dt 28 . 08 .2023

PËR

**“MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NIVELIT TË PAGAVE PËR POLICINË  
BASHKIAKE TË BASHKISË VAU DEJËS PËR VITIN 2023”**

Bazuar në nenin 53 pika 2, neni 54 pika ç, e ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, të ligjit nr 68/2017 “Për financat e veteqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, ligji 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar; ligjit 152/2013 ‘Për nëpunësin civil’ të ndryshuar; ; ligji nr 89/2022 “Për Policinë Bashkiake” neni 28, pika 1; VKM nr 113 datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës bazë minimale në shkallë vendi”; VKM nr 328 datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, sipas VKB nr 84 datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Vau Dejës, dhe me shkresë nr 24/1 dt 12.01.2023 të miratuar nga Prefektura Shkodër dhe sipas relacionit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë, Këshilli Bashkiak pasi diskutoi materialin e paraqitur në mbledhjen e tij të datës 26 . 08 . 2023

V E N D O S I:

1. Miratimin e nivelit të pagave për policinë bashkiake të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2023 si me poshte vijon:  
Niveli i pagave për policinë bashkiake ndryshohet sipas lidhjes 1.
2. Ky vendim i shtrinë efektet financiare nga data 01.04.2023 deri me datë 31.12.2023.
3. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
4. Fond i pagave përballohet nga transferta dhe të ardhurat e bashkisë.



5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar).

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

**Ardian Çelepija**

Miratuar me 18 vota

Vota Pro 18


Vota Kundër —

Vota Abstenim —

Zbardhur me datë 01 . 09 .2023.

**Kryetari Këshillit Bashkiak**

**Ervis Shimaj**





## Lidhja Nr 1: Niveli i pagave për policinë bashkiake për vitin 2023

VKM nr 328 datë 31.5.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore".

Pozicioni	Numri i punonjësve	Ligji i aplikueshem	Klasa/kateg, e pages	Pozicioni	Niveli Arsimor	Vjetersia
Emertimi	Punonjës	Zgjedhur, emeluar	Kategoria	Pozicioni	Paga baze mujore	Shtesa per vjetersi, ne perqindje
<b>Policia Bashkiake</b>	<b>10</b>				<b>Arsim i Larte/Mesem</b>	
K/Inspektor	1		III-a/1	70,000		2%
Inspektor	1		III-b	56,000		2%
Polic Bashkiak	1		IV-a	44,000		2%
Polic Bashkiak	1		IV-a	44,000		2%
Polic Bashkiak	1		IV-a	44,000		2%
Polic Bashkiak	1		IV-a	44,000		2%
Polic Bashkiak	1		IV-a	44,000		2%
Polic Bashkiak	1		IV-a	44,000		2%
Polic Bashkiak	1		IV-a	44,000		2%
Polic Bashkiak	1		pika 11	47,000	Arsimi i Mesem	2%

Sekretari i Këshillit

Ardian Celepija

Kryetari i Këshillit

Ervis Shimaj